Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e71-të, të mbajtur më 30.06.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Procedura sipas lëndës me numër 12-1136 / 1 nga data 11.03.2021, , NDËRPRTET.

KSHPK vërtetoi se lënda nuk ka elemente për veprimin e saj kompetent në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

Lënda me numër 12-1136 të vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-1136/1të datës 20.07.2021 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga parashtruesi panjohur. Në denoncim janë nxjerrë pohime lidhur me sjelljen e paarsyeshme dhe abuzimin e pozitës dhe autorizimeve zyrtare nga ///, person zyrtarë ///, në mënyrë që të arrihet përfitimi personal. Bëhen dyshime për pagimin e paligjshëm të pagesave të detyrimeve, mos zbatimin apo zbatimin e paligjshëm të prokurimit publik dhe mosrespektimin e legjislacionit të punës. Nga KSHPK kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Prova ndaj denoncimit nuk u dorëzuan.

Pas shqyrtimit të pohimeve në denoncim, KSHPK-ja iu drejtua me kërkesë për trajtim kompetent dhe mbledhje të dhënash, informacionit dhe dokumentacionit për rastin konkret, Inspektoratit Shtetëror Administrativ, Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Drejtorisë së të ardhurave publike, të cilat vepruan në mënyrë konsekuente sipas kërkesave të KSHPK-së. Provat e siguruara KSHPK-ja i dorëzoi në drejtorinë e policisë financiare si dhe ka kërkuar veprime kompetente të saj për rastin konkret. Duke vepruar sipas kërkesës së KSHPK-së, Drejtoria e Policisë Financiare ka raportuar se ka ofruar prova në lidhje me pretendimet nga denoncimi, konkretisht në lidhje me moszbatimin apo zbatimin e paligjshëm të prokurimeve publike dhe do të njoftohet prokurori publik kompetent. për të ndërmarrë masa dhe veprime të mëtejshme.

Nga e theksuara sa më sipër, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka juridiksion për të vepruar në përputhje me LPKKI dhe vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:
Parashtruesi i denoncimit

Përgaditi: Mr D. D.

KOMISIONI SHTETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Nënkryetar,
Nuri Bajrami